



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.344, datë 23.09.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence*" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "*Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 23.09.2021 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësajllës Kanalizime Durrës sh.a.",

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësajllës Kanalizime Durrës (**UK Durrës**) me shkresën nr. 3127/2 prot. ERRU, datë 18.08.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Durrës në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "*Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*" (**VKM nr. 63**).
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:
 - a) Shoqëria UK Durrës ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 355,298 banorë të Bashkisë Durrës, Shijak dhe Njësitë Administrative Bubq (Bashkia

Krujë), Thumane (Bashkia Krujë), Fushë-Kuqe (Bashkia Kurbin), Prezë (Bashkia Vorë), si dhe përpunimin e ujërave të ndotura në ITUN Durrës me një kapacitet për rreth 250,000 banorë të qytetit të Durrësit, zonës së plazhit dhe fshatrat përreth tij.

- b) Drejtuesit teknik z. Gerald Dautaj është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Hidroteknike, në vitin 2013 dhe ka mbi 5 vite përvojë në profesion.
 - c) Drejtuesi teknik z. Lorenc Façja është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Hidroteknike në vitin 2012 dhe ka mbi 5 vite përvojë në profesion;
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Durrës, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Durrës është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a me (NUIS J61819502V), në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
 - c) Kategoria D - Për trajtimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues Ligjor – Spartak Kovaçi
- b) Drejtues Teknik – Gerald Dautaj
- c) Drejtues Teknik – Lorenc Facja

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a është:

Bashkia: Durrës, Shijak
Njësia administrative: Bubq, Thumane (Bashkia Krujë)
Fushë-Kuqe (Bashkia Kurbin)
Prezë (Bashkia Vorë)

- 4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
- 5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
- 6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani